



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.26/ 14 prot.

Datë 29.02.2024

V E N D I M
Nr. 234 / 2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 177/2024, datë 14.02.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar - Mallra”, me objekt “Blerje pluhur hipoklorit kalciumi”, me Nr. REF-92520-12-29-2023, me fond limit: 4,980,000 (Katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë: Rruga e Kavajës, Buka Sh.A, Nr. 8240, Njësia nr. 6, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale “Ujësjetllës Kanalizime Durrës” Sh.A.
Adresa: L.17 Rr. “Dalip Peza”.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 14.02.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.177/2024, ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar - Mallra”, me objekt “Blerje pluhur hipoklorit kalciumi” me Nr. REF-92520-12-29-2023, me fond limit: 4,980,000 (Katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 21.12.2023, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A.*
2. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.*
3. *Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në sistemin elektronik të prokurimeve.*
4. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
5. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 36/27 prot., datë 23.02.2024, protokolluar me tonën nr. 26/11 prot., datë 26.02.2024, autoriteti kontraktor, njofton se: *“Referuar Vendimit 177/2024 datë 14.02.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar me tonën me nr. 17/10 prot., datë 19.02.2024, në lidhje me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pluhur hipoklorit kalciumi” me fond limit: 4,980,000 (Katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, me Nr. REF-92520-12-29-2023, ju bëjmë me dije se Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A në cilësinë e autoritetit kontraktor ka ngarkuar një shtojcë në SPE me ndryshime në përputhje me konstatimet dhe vendimin 177/2024 datë 14.02.2024 të KPP-së”.*

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën nr. 36/27 prot., datë 23.02.2024, protokolluar me tonën nr. 26/11 prot., datë 26.02.2024, autoriteti kontraktor, njofton se: *“Referuar Vendimit 177/2024 datë 14.02.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar me tonën me nr. 17/10 prot., datë 19.02.2024, në lidhje me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK*

për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pluhur hipoklorit kalciumi” me fond limit: 4,980,000 (Katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, me Nr. REF-92520-12-29-2023, ju bëjmë me dije se Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A në cilësinë e autoritetit kontraktor ka ngarkuar një shtojcë në SPE me ndryshime në përputhje me konstatimet dhe vendimin 177/2024 datë 14.02.2024 të KPP-së”.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka modifikuar dokumentat e tenderit, nëpërmjet një shtojcë për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, dhe e ka publikuar, e cila është në përputhje me vendimin Nr. 177/2024, datë 14.02.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor Autoriteti i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A, ka zbatuar vendimin Nr. 177/2024, datë 14.02.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar - Mallra”, me objekt “Blerje pluhur hipoklorit kalciumi”, me Nr. REF-92520-12-29-2023, me fond limit: 4,980,000 (Katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

